



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



**KRYETARI I KOMUNËS**

14-030/01-178876/22, më 27. 07. 2022

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, me 28/04, qershori 2008), të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë

**V E N D I M**

- I. MIRATOHET Vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit për organizimin, kompetencat, përgjegjësitë dhe sistematizimin e vendeve të punës së administratës komunale nr. 01-031-13761 i dt. 19.01.2016.
- II. Plotësohet neni 4, paragrafi 4.1 i vendimit si në pikën I, duke e shtuar Drejtorinë e Menaxhimit të Hapësirave Publike dhe Parqeve, e cila është e organizuar në dy sektorë:
  1. Sektori për Menaxhimin e Hapësirave Publike dhe
  2. Sektori për Menaxhimin e Parqeve.
- III. Drejtoria për Menaxhimin e Hapësirave Publike dhe Parqeve, në kuadër të fushë veprimtarisë së saj ushtron dhe është përgjegjëse për:
  - a) Evidentimi i zonave të përshtatshme për krijimin e hapësirave të reja të gjelbërtë në secilën zonë të kryeqytetit;
  - b) Krijimi dhe administrimi i Parqeve (përfshirë: rekreative, memoriale, botanike, tematike) brenda territorit të Komunës së Prishtinës;
  - c) Krijimi dhe administrimi i hapësirave me lodra për fëmijë;
  - d) Intervenimet urbane kulturore dhe rekreative në Hapësira publike dhe Parqe;
  - e) Përcaktimi, administrimi i mobilerisë urbane në Hapësira publike dhe Parqe;
  - f) Mbrojtja dhe kujdesi ndaj zonave të gjelbërtë brenda territorit të Komunës së Prishtinës;
  - g) Administrimi dhe krijimi i aseteve rekreative (pajisje, pista e shtigje, ambiente rekreative) që ndodhen në territorin e Komunës së Prishtinës;
  - h) Krijimi dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e këndeve të lodrave për fëmijë;

- i) Nxitja, promovimi, mbështetja dhe organizimi i aktiviteteve rekreative për fuqizimin e jetesës aktive nëpërmjet edukimit e sensibilizimit për një jetesë të shëndetshme, në bashkëpunim me sektorë të tjera përgjegjës;
- j) Organizimi dhe koordinimi i planeve operacionale të gjelbërimit;
- k) Hartimi i planeve operacionale dhe përcaktimi për mbarështimin e kurorave të gjelbërtë dhe krijimin e koridoreve të gjelbërtë brenda territorit të Komunës së Prishtinës;
- l) Dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e hapësirave në Parqe;
- m) Përcaktimi i kushteve për dhënien e pëlqimit për shfrytëzimin e hapësirave publike (të gjelbërtë) në përputhje me rregulloret komunale;
- n) Informimi i publikut për çështjet që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe mbrojtjen e hapësirave të gjelbërtë;
- o) Emërtimi i secilës prej hapësirave të gjelbërtë brenda territorit të Komunës së Prishtinës;
- p) Bashkërendimi me dikasterët e tjera të nivelit lokal dhe ministrinë e linjës mbi çështje që lidhen me hapësirat e gjelbërtë;
- q) Punë të tjera në kuadër të fushë-veprimtarisë së Drejtorisë, potencoohen Ndërmarrjet Publike Komunale të cilat menaxhohen nga kjo Drejtori, në përputhje me ligjet në fuqi.

**IV.** Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit për organizimin, kompetencat, përgjegjësitë dhe sistematizimin e vendeve të punës së administratës komunale nr. 01-031-13761 i dt. 19.01.2016.

**V.** Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat e Vendimit nr. 01-031-13761 i dt. 19.01.2016 që bien në kundërshtim me këtë Vendim.

**VI.** Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

#### **U DORËZOHET:**

- Kësaj Drejtorie;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

**KRYETARI I KOMUNËS**  
**Përparim Rama**

